

# Raporti Vjetor i Cilesise se Ajrit

## Tirana, 2012



**Laboratori i Monitorimit te Ajrit  
Inst. Shendetit Publik, Tirane  
Rruga ‘A.Moisiu’, Nr.80**

**Mars 2013**

*Raporti Vjetor i Cilesise se Ajrit, Tirana 2012*

Informacion per dokumentin:

Autor: Agron Deliu, Kimist Toksikolog

Aprovuar prej:

Prof.Dr. Enver Roshi, Drejtor i Institutit te Shendetit Publik

Departmenti: Mjedisi dhe Shendet

Adresa: Rruga ‘A.Moisiu’ Nr. 80, Tirane ,

Telefon: 067 2052671, 067 2013660

Email: [agrondel@gmail.com](mailto:agrondel@gmail.com)    [enviroshi@gmail.com](mailto:enviroshi@gmail.com)

Dt. 22 Shkurt 2013

## **Permbajtja**

1. Hyrje.....	4
1.1 Efektet shendetore te ndotjes se ajrit.....	4
1.2 Cilesia e ajrit ne qytetin e Tiranes. ....	4
1.3 Menaxhimi i cilesise se ajrit – legjislacioni dhe politikat.....	4
2. Monitorimi i cilesise se ajrit ne qytet.....	6
2.1 Sfondi i monitorimit te cilesise se ajrit ne qytet .....	6
2.2 Monitorimi i cilesise se ajrit ne vitin 2012 .....	6
3. Rezultatet e cilesise se ajrit.....	9
3.1 Variacionet stinore .....	9
3.2 Monoksidi i karbonit (CO).....	9
3.3 Dyoksidi i azotit (NO <sub>2</sub> ).....	11
3.4 Dyoksidi i sulfurit (SO <sub>2</sub> ).....	12
3.5 Ozoni (O <sub>3</sub> ).....	13
3.6 Grimcat e imta (PM <sub>10</sub> and PM <sub>2.5</sub> ).....	15
3.7 Benzeni .....	18
4. Diskutim.....	21
Apendiks A.....	24
Apendiks B.....	26
Apendiks C.....	28

## 1. Hyrje

*Raporti Vjetor i Cilesise se Ajrit, Tirana 2012* jep rezultatet e monitorimit te cilesise se ajrit ne qytetin e Tiranës nga 1 janari deri 31 dhjetor 2012. Kapitulli i pare trajton ndotjen e ajrit ne qytetin e Tiranës, me një diskutim te shkurter te sfondit ligjor dhe shkencor. Rrjeti monitorues i qytetit paraqitet ne kapitullin 2. Kapitulli 3 jep rezultatet e gjithe monitorimit te viti 2012. Keta rezultate diskutohen ne kapitullin 4. Ne Apendikset A,B dhe C janë futur tabela dhe permblehdhje ndihmese.

### 1.1 Efektet shendetosore te ndotjes se ajrit

Ekspozimi ndaj ndotjes se ajrit mund te jape efekte akute (te shpejte, te forte e te shkurter) dhe kronike (me kohe zgjatje mbi 3 mujore) mbi shendetin e njeriut. Disa njerez Jane me te ndjeshem ndaj efekteve te ndotjes se ajrit se te tjeret. Njerezit me semundje ekzistuese te zemres apo te mushkerive, femijte dhe te moshuarit Jane vecanerisht te ndjeshem. Efektet e per gjithshem shendetosore te formave kryesore te ndotjes se ajrit jepen ne apendiksin B.

Instituti i Shendetit Publik operon një sistem monitorues te ajrit që mund te jape informacion per publikun. Per vitin 2014 parashihet qe nje informim i tille te jepet per here te pare ne rruge elektronike, per t'i paralajmeruar njerezit per ndotjen dhe per tu dhene keshilla shendetosore, ne menyre qe ata te jene ne gjendje te marrin edhe masa vetiake per te zvogeluar mundesine e efekteve potenciale.

### 1.2 Cilesia e ajrit ne qytetin e Tiranes

Qyteti i Tiranës perballët me ndotjen me serioze te ajrit ne Shqipëri. Kjo shkaktohet se pari nga densiteti i zhvillimit dhe pozicionimi i saj gjeografik. Trafiku rrugor eshte burimi kryesor i ndotjes, te cilil i shtohen aktiviteti i ndertimit dhe ngrohja e banesave. Ndotesit e krijuar nga trafiku perfshijne hidrokarburet, oksidet e azotit, lenden e grimcuar dhe monoksidin e karbonit. Praktikisht Tirana nuk ka tashme burime te rendesishem industrial te ndotjes se ajrit, si dy-tre dekada me pare.

### 1.3 Menaxhimi i cilesise se ajrit – legjislacioni dhe politikat

Politikat kombetare per cilesine e ajrit shprehen ne nje seri ligjesh e vendimesh te rrjedhur prej tyre, qe jepen me poshte:

- Ligji Nr 8897 dt.16 .5. 2002, mbi *Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja*, modifikuar prej ligjit Nr.10 266, dt. 15.4.2010 *Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin Nr 8897 dt.16 .5. 2002*
- Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr 435 dt. 12.9.2002 mbi *Miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise*
- Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr 803 dt 04.12.2003 mbi *Miratimin e normave te cilesise se ajrit*
- Udhezimi i Ministrise se Mjedisit dhe Ministrise se Transportit e Telekomunikacioneve Nr 6527 dt. 24.12.2004 mbi *Vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit nga shkarkimet e gazrave, shkaktuar nga mjetet rrugore.*

Modifikimi i vitit 2010 i ligjit ekzistues te mbrojtjes se ajrit nga ndotja fuqizon mjaft rolin e pushtetit vendor per monitorimin dhe kontrollin me efikas te cilesise se ajrit.

Edhe pse normat e vendosura dhe logjikat e ligjeve dhe akteve nenligjore respektive tentojne ne menyre konstante perafrimin me direktivat e KE per cilesine e ajrit, zbatimi praktik i ketij legjislacioni eshte mjaft i dobet.

## 2. Monitorimi i cilesise se ajrit ne qytet

### 2.1 Sfondi i monitorimit te cilesise se ajrit.


Qyteti i Tiranes ka monitoruar cilesine e ajrit qe ne mesin e viteve 1970. Monitorimi fillimisht eshte fokusuar te dyoksidit i squfurit dhe bloza, ne perqjigje te ligjit te atehershem te mbrojtjes se mjedisit. Pas viteve 2000 vemendja e monitorimit te cilesise se ajrit u cvendos per t'ju perqjigjur ndryshimeve te burimeve predominues te ndotjes. Fillimisht burimet kryesore ishin industria dhe djegia e qymyrit dhe e druve, por keta ja lene vendin automjeteve.

Qyteti tashme mund te konsiderohet nje zone problematike per permbajtjen ne ajrin e vet te grimcave te imta e te dyoksidit te azotit, dhe monitorimi i cilesise se ajrit po fokusohet ne 'ta. Monitorohen edhe nje numer ndotesish te tjere, per te kontrolluar ecurine e tyre ndonese jane te rendesise sekondare. Programi i monitorimit ne qytet eshte ne permiresim e siper, per efekt te dy stacioneve automatike te sjelle ne maj te vitit 2010 nga qeveria gjermane / OBSH per ISHP, dhe ngritjen e aftesive teknike te ketij institucioni.

### 2.2 Monitorimi i cilesise se ajrit ne vitin 2012

Monitorimi i cilesise se ajrit ne vitin 2012 eshte kryer me dy stacione automatike me funksionim te vazhdueshem dhe me dy fushata dy javore secila me tuba difuze.

Figura 2.2.1 tregon vendosjen e te gjitha pikave te monitorimit.



### ***Stacionet automatike***

Tabela 2.2.2 jep nje permblehdje te monitorimit te ajrit ne qytet duke perdonur dy stacione me pune te panderprere. Te dhenat e ketyre stacioneve jane procesuar e koregjuar sipas standardesh teknik perkates, me asistencen e eksperteve te projektit CEMSA te delegacionit te KE ne Tirane. Kjo pershkruhet dhe diskutohet me tej ne sektionet 3.2 dhe 3.6.

Dy pikat e monitorimit te vazhduar jane te perfshira ne rrjetin e monitorimit te ajrit per Tiranen, te operuar prej ISHP, laboratorit te cilesise se ajrit.

Tabela 2.2.2 Monitorimi i cilesise se ajrit ne 2012 duke perdonur stacione me pune te vazhduar

Adresa	Klasifikimi stacionit	O <sub>3</sub>	NO <sub>2</sub>	PM 1	PM2.5	PM10	CO	SO <sub>2</sub>	BTX
1.Rruga Q.Stafa Poliklinika qendrore,	Residencial	X	X	X	X	X	X	X	X
2. Rruga A.Moisiu ISHP	Background residencial	X	X	X	X	X	X	X	X

### ***Tubat difuze***

Tabela 2.2.3 jep nje permblehdje te monitorimit te ajrit gjate vitit 2012 ne qytet duke perdonur tuba difuze. Keta jane me pak te sakte per monitorimin e cilesise se ajrit se stacionet automatike, por jane te dobishem per kontrollin e me shume pikave dhe percaktimin e zonave ‘te nxeha’. Tubat jane eksposuar dy here, ne janar dhe ne qershori, per periudha dy javore. Ata jane sjelle prej projektit CEMSA te delegacionit te KE nga firma angleze Gradko, dhe pas ekspozimit dy favor Jane kthyer ne laboratoret atje ku edhe jane analizuar.

Ata pershkruhen dhe diskutohen me tej ne sektionet 3.3 dhe 3.7.

Tabela 2.2.3 Monitorimi i cilesise se ajrit ne 2012 duke perdonur tuba difuze

Adresa	Klasifikimi stacionit	O <sub>3</sub>	NO <sub>2</sub>	SO <sub>2</sub>	Benzen
3.Linze	Residencial rural	X	X	X	X

4. Kombinat	Residencial	X	X		X
5. Kodra e Diellit	Residencial	X	X		X
6.Kryqezimi 21 Dhjetori	Trafik	X	X	X	X
7.Stadiumi S.Stermasi	Residencial	X	X		X
8. DSHP – Tirane	Residencial	X	X	X	X
9. Stacioni i Trenit	Trafik	X	X		X
10. Kryqezimi Zogu i Zi	Trafik	X	X	X	X
11. Klinika iraniane	Residencial	X	X		X
12. Kryqezimi Farmacia 10	Trafik	X	X		X

### 3. Rezultatet e cilesise se ajrit

#### 3.1 Variacionet stinore

Ka tendencia stinore te per gjithshme ne cilesine e ajrit qe lidhen me kushtet e motit. Cilesia e ajrit ne dimer eshte me e renduar se ne stinen e veres e te pranveres. Kjo per arsyet e meposhtme:

- Dimri: Ne dimer ndotjes se shkarkuar nga makinat i shtohet edhe ndotja e shkarkuar nga djegia e lendeve djegese per ngrohje. Kjo ndotje ne per gjithesi mbetet mbi qytet, kur ajri ne lartesi rreth 80-100m eshte me i ngrohte se ajri ne nivelin e tokes. Kjo gje shkakton formimin e nje fare ‘kapaku’ qe nuk lejon shperhapjen e ndotjes dhe fenomeni njihet si inversion temperature. Keto kushte jane vecanerisht dominuese ne ditet e ftohta e pa ere, shpesh pas nje nate pa re dhe kur mengjezi eshte me ngrice. Reshjet e shiut per gjithsisht ulin permbajtjen e ndotesve ne ajer, vecanerisht ate te grimcave te imta.
- Vera: Ne vere drita e diellit reagon me ndotjen e shkarkuar prej makinave. Ky veprim rezulton ne rritjen e permbajtjes se ozonit ne nivelin e siperfaqes se tokes.

#### 3.2 Monoksidi i karbonit (CO)

Monoksidi i karbonit (CO) eshte nje gaz pa shije, ngjyre dhe ere. Burimi i tij kryesor ne ajrin mjedisor eshte transporti rrugor. Por edhe proceset e djegies per ngrohje nga popullata jane nje burim i konsiderueshem.

Ne qytetin e Tiranes burimi kryesor eshte djegia jo e plete e karburanteve ne automjetet rrugore dhe perqendrimet me te larte hasen prane rrugeve.

Tabela 3.2.1 Rezultatet e monitorimit automatik te monoksidit te karbonit: krahasimi me objektivin e KE.

Nr	Vendi	Ditet e monitoruara ndaj diteve te plota kalendarike, 2012	Numri i diteve ku mesatarja ka kapercyer $10 \text{ mg/m}^3$
1	Poliklinika qendrore	96%	0
2	ISHP	99%	0

Perqendrimet e monoksidit te karbonit determinohen prej mases se shkarkimeve dhe dispersionit. Ato jane me te larta ne muajt e dimrit kur dispersioni i atmospheres eshte i dobet. CO ne atmosphere oksidohet deri ne dyoksid karboni ( $\text{CO}_2$ ).


Monitorimi per CO ne qytetin e Tiranes ka filluar ne vitin 2010. Qe atehere perqendrimet rezultojne te ulet dhe ne asnje rast nuk eshte kapercyer shifra e objektivit te cilesise se ajrit te vendeve te KE.

Tabela 3.2.2 dhe grafiku 3.2.3 tregon perqendrimet mesatare mujore te CO qe jane te ulta ne te dy pikat gjate tere vitit 2012. Vlera me e larte ditore e kapur eshte  $2.9 \text{ mg/m}^3$ .

Tabela 3.2.2

	Pika 1 Poliklinika qendrore	Pika 2 ISHP
janar	1.23	0.39
Shkurt	0.87	0.44
Mars	0.51	0.41
Prill	0.59	0.27
Maj	0.3	0.3
Qershor	0.3	0.25
Korrik	0.16	0.25
Gusht	0.27	0.39
Shtator	0.45	0.31
Tetor	0.48	0.24
Nendor	0.58	0.32
Dhjetor	0.86	0.7

Grafiku 3.2.3



### 3.3 Dyoksoidi i azotit ( $\text{NO}_2$ )

Dyoksoidi i azotit eshte me shume nje ndotes sekondar, i formuar prej oksidimit te oksidit nitror NO. Ne qytetin e Tiranes burimi primar i oksidit nitror jane makinat, ndonese po rritet edhe kontributi relativ nga banesat (ngrohja dhe ftohja). Ndikimet mbi shendet te dyoksidit te azotit diskutohen ne Apendiksin B. Si edhe ne rastin e monoksidit te karbonit, perqendrimet kane prirje te jene me te larta gjate muajve te dimrit, kur dispersioni eshte me i dobet.

Tabela 3.3.1 Rezultatet e monitorimit automatik te dyoksidit te azotit: krahasimi me objektivat e KE.

Nr	Vendi	Ditet e monitoruara ndaj diteve te plota kalendarike, 2012	Numri i hereve ku jane kapercyer:	
			Mesatarja orare (200 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ , duhet te jetet me pak se 18 here/vit)	Mesatarja vjetore (40 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )
1	Poliklinika qendrore	99%	0	42.3 <b>Tejkaluar</b>
2	ISHP	99%	0	6.5


Ne qytetin e Tiranes dyoksoidi i azotit eshte monitoruar duke perdorur dy stacionet automatik me pune te vazhdueshme gjithe vjetore dhe dhjete pika ku jane montuar dy here nga dy jave (janar dhe qershor) tubat difuze. Tabela 3.3.2 dhe grafiku 3.3.3 jepin rezultatet mesatare vjetore ne te gjitha pikat e monitorimit. Grafiku 3.3.4 jep ecurine mujore te  $\text{NO}_2$  ne dy stacionet automatike te Tiranes.

Stacionet automatike jepin te dhena orare dhe ditore, ndersat tubat difuze jepin te dhena mesatare dy javore. Verehet qarte se permbytja e dyoksidit te azotit ne qendren e qytetit dhe ne kryqezimet e trafikut tashme kapercen vleren kufi te KE ( $40 \mu\text{g}/\text{m}^3$ ), ndersa ne asnjë rast nuk eshte kapur kapercim i vleres kufi orare te KE ( $200 \mu\text{g}/\text{m}^3$ )..


Tabela 3.3.2

Nr	Vendi	Vlera
1	Poliklinika qendrore	42.6
2	ISHP	6.5
3	Linze	3.5
4	Kombinat	11.5
5	Kodra Dielli	17.2
6	21 dhjetori	65.1
7	Stadiumi S.Stermasi	29.6
8	DSHP	33.7
9	Stacioni trenit	52.4
10	Zogu I Zi	66.4
11	Klinika iraniane	30.2
12	Farmacia 10	49.5

Tabela 3.3.3



Grafiku 3.3.4



### 3.4 Dyoksidi i squfurit ( $\text{SO}_2$ )

Dyoksidi i squfurit ( $\text{SO}_2$ ) eshte nje gaz pa ngyre , i cili ne perqendrime te larte ka shije dhe ere. Ai mund te formohet prej aktivitetit te njjeriut, por haset edhe natyralisht. Djegia e naftes dhe qymyrit, si edhe e gazit , kur keta parmbajne squfur mund te konsiderohet si burimi kryesor i formimit te tij. Edhe me keto kontribute, mund te thuhet me siguri qe permbajtja e tij ne ajrin e qytetit te Tiranes eshte me e ulet se ajo e lejuar prej legjislacionit te KE.


Eshte ky nje fenomen mbare europian, qe lidhet se pari me uljen e permbajtjes se tij ne lendet djegese me baze nafte, per efekt te teknologjive te heqjes se squfurit ne keto lende tre dekadat e fundit. Naftat shqiptare permbajne perqindje te larta squfuri (3-6 perqind), si edhe nen produktet e tyre, por ne vedin tone perdoren per rreth 2/3 lende djegese importi me permbajtje squfuri nen ate te naftave tonë.

Kjo ben qe  $\text{SO}_2$  i formuar te jetë ne sasi relativisht te vogla. Tabela 3.4.1 dhe grafiku 3.4.2 tregon permbajtjet mesatare vjetore te  $\text{SO}_2$  ne ajer ne te gjitha pikat e monitoruara ne Tirane (dy pikat me stacione automatike dhe kater pika me tuba difuze). Ne asnje rast nuk kapercehet perqendrimi i lejuar ne vendet e KE.

Tabela 3.4.1

Nr	Vendi	Vlera, $\mu\text{g}/\text{m}^3$
1	Poliklinika qendrore	8.4
2	ISHP	5.1
3	Linze	4.6
4	21 dhjetori	13.1
5	DSHP	6.2
6	Zogu I Zi	16.9

Tabela 3.4.2



### 3.5 Ozoni ( $\text{O}_3$ )

Ozoni ( $\text{O}_3$ ) eshte një gaz mjaft reaktiv, qe ekziston ne pjesen e poshtme te atmosferes (nivelin e tokes) por edhe ne troposfere. Ai nuk shkarkohet direkt nga njeriu, por formohet nga reaksionet kimike mes ndotesish te tjere, shpesh te inicuar prej drites se forte te diellit. Me qe eshte një ndotës sekondar, masat per ta menaxhuar ozonin ne nivel lokal kane provuar se kane efektivitet te ulet.

Ozoni i nivelit te shtreses se poshtme mund te haset ne distance te konsiderueshme prej burimit te ndotësve primare qe e formojne ate, dhe perqendrimet maksimale nuk gjenden zakonisht te burimi i tyre.

Ne zona urbane oksidi nitror ( $\text{NO}$ ) mund te reagoje me ozonin per te formuar dyoksid azoti ( $\text{NO}_2$ ). Kjo mund te pakesoje perqendrimet e ozonit ne nivelin e tokes por te rrise ato te dyoksidit te azotit. Ne zonat rurale kjo nuk ka si te ndodhe ne te njejtën mase dhe nivelet e ozonit janë gjetur te jene me te larte ne zona rurale se ne ato urbane.

Perqendrimet e larte te ozonit mund te demtojne funksionin e mushkerive dhe te shkaktojne irritim te traktit respirator. Azmatiket janë vecanerisht te ndjeshem ndaj niveleve te tij te larte. Efektit shendetësore te ekspozimit ndaj ozonit diskutohen me poshte ne Apendiksin B.

Ozoni eshte monitoruar me dy stacionet automatike gjate vitit 2012 ne qender te qytetit (poliklinika qendrore) dhe ne zonen e ISHP. Po ashtu eshte matur edhe me tuba difuze, ne 10 pika te tjera, analogjikisht si rasti i dyoksidit te azotit.

Normat e KE sugjerojne qe nje mesatare ditore 8 oreshe prej  $120 \mu\text{g}/\text{m}^3$  nuk duhet te kalohet me shume se 18 here ne vit. Ne rastin e vitit 2012 kjo eshte tejkaluar 24 here ne stacionin e qendres dhe 99 here ne stacionin e ISHP.

Tabela 3.5.1 Rezultatet e monitorimit automatik per ozonin: krahasimi me objektivat


Nr	Vendi	Ditet e monitoruara ndaj diteve te plota kalendarike, 2012	Numri i diteve ku mesatarja ka kapercyer $120 \mu\text{g}/\text{m}^3$
1	Poliklinika qendrore	97%	24
2	ISHP	99%	99

Nivelet e larte te ozonit hasen ne muajt e veres per efekt te rrezatimit me te forte diellor. Kjo shihet qarte ne tabelen 3.5.2 dhe grafikun 3.5.3 te ndertuat nga te dhenat mesatare 8 oreshe ditore nga dy stacionet automatike.

Tabela 3.5.2


	Poliklinika qendrore	ISHP
Janar	26	58.7
Shkurt	49.04	77.52
Mars	68.14	93.28
Prill	68.08	92.72
Maj	81.88	100.82
Qershor	93.68	121.28
Korrik	99.26	126.08
Gusht	103.96	136
Shtator	73.08	109.96
Tetor	52	81.98
Nendor	35.36	58.26
Dhjetor	39.68	58.84

Grafiku 3.5.3



Duke dhene ne grafikun 3.5.4 te gjitha pikat e monitorimit, te ndara ne periudhen dimer/vere do te kishim:

Grafiku 3.5.4



### 3.6 Grimcat e imta (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>)

PM<sub>10</sub> eshte lende e grimcuar e imet, me diameter grimcash me te vogel se 10 mikron. Ajo ka dy burime kryesore, primare (e shkarkuar direkt) dhe sekondare (e ndryshuar kimikisht ose fizikisht ne atmosferë). Ndersa PM<sub>2.5</sub> eshte lenda e grimcuar shume e imet, me diameter grimcash me te vogel se 2.5 mikron.

Keto lloj grimcash te ajrit konsiderohen aktualisht prej Organizates Boterore te Shendetise (OBSH) si ndotesit me te rrezikshem urban per shendetin e njeriut

Tabela 3.6.1 Rezultatet e monitorimit me stacione automatik per PM<sub>10</sub>: krahasimi me objektivat.

Nr	Vendi	Ditet e monitoruara ndaj diteve te plota kalendarike, 2012	Perqendrimi mesatar vjetor ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )		Numri i tejkalimeve te objektivit mesatar ditor (50 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	
			Viti 2011	Viti 2012	Viti 2011	Viti 2012


1	Poliklinika qendrore	99.5%	52.6	34.2	156	49
2	ISHP	99.5%		38.1		80

Tabela 3.6.2 Rezultatet e monitorimit me stacione automatik per PM2.5: krahasimi me objektivat.

Nr	Vendi	Ditet e monitoruara ndaj diteve te plota kalendarike, 2012	Perqendrimi mesatar vjetor ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	
			Viti 2011	Viti 2012
1	Poliklinika qendrore	99.5%	28.3	20.1
2	ISHP	99.5%		19.8


Grafiku 3.6.3 tregon nivelet mesatare ditore te PM10 ne te dyja pikat e stacioneve automatike per vitin 2012. Mesatarja ditore prej  $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$  eshte tejkaluar 49 here ne piken e stacionit te qendres se qytetit, dhe 80 here ne piken e stacionit te ISHP.

Grafiku 3.6.3



Grafiku 3.6.4 tregon tendencen mesatare vjetore te PM10 ne piken e qendres se qytetit per dy vitet 2011 dhe 2012. Mesatarja vjetore e vitit 2012 ka rene nen normen e KE, me normalizimin e trafikut atje ne fund te vitit 2011.

Grafiku 3.6.4




Gjate vitit 2012 pati një rast renie zjarri ne shpatin perendimor te malit te Dajtit, ne gjysmen e dyte te muajit gusht (fot. 3.6.5). Ne ate rast te dy stacionet automatike regjistruan rritje te shprehur te permbajtjeve te PM10 e PM2.5 ne ajrin e qytetit te Tiranes (graf. 3.6.6), ne periudhen respektive.

Fot. 3.6.5



Graf. 3.6.6



### 3.7 Benzeni

Benzeni eshte nje hidrokarbur aromatik. Ne qytetin e Tiranes burimi primar i benzenit eshte shkarkimi nga automjetet qe perdonin benzinen si karburant. Permbajtja e tij ne ajer eshte akoma brenda normes se lejuar ne vendet e KE.

Ne menyre te ngjashme me dyoksidin e azotit, benzeni eshte matur ne dy stacione automatike (ne qender te qytetit dhe ne zonen e ISHP) gjate tere vitit 2012, si edhe ne pikat te tjera te qytetit me dy seri analizash te tubave difuze (dimer/vere). Keta rezultate jane perdorur per te llogaritur një vlerë mesatare vjetore te permbajtjeve te tij ne ajer.

Tabela 3.7.1 Rezultatet e monitorimit automatik te benzenit: krahasimi me objektivat e KE.

Nr	Vendi	Ditet e monitoruara ndaj diteve te plota kalendarike, 2012	Perqendrimi mesatar vjetor ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ ). Norma KE = 5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$
1	Poliklinika qendrore	99.5%	4.05
2	ISHP	36.1%	2.79

Ne rastin e dy fushatave me tuba difuze, permbajtjet mesatare te benzenit ne ajer jepen ne tabelen 3.7.2.

Tabela 3.7.2


Nr	Vendi	Vlera
3	Linze	2.04
4	Kombinat	1.85
5	Kodra Dielli	2.51
6	21 dhjetori	5.1
7	Stadiumi S.Stermasi	2.88
8	DSHP	3.44
9	Stacioni trenit	3.15
10	Zogu I Zi	3.37
11	Klinika iraniane	3.76

12 Farmacia 10

1.74

Ne grafikun 3.7.3 jepen rezultatet mesatare vjetore te perfshuar nga dy stacionet automatike dhe pikat e monitoruara me tuba difuze.


Grafiku 3.7.3



## 4. Diskutim

Stacioni i Tiranes qender ka nje ulje te shprehur te PM 10 e te PM 2.5 ne ajer ne krahasim me vitin 2011, ne masen 20-30 perqind. Kjo si rezultat i ‘hapjes’ se qendres per trafik normal, pas dt. 15.11.2011. Sidoqofte ecuria e kesaj ulje duhet ndjekur ne vijimesi, per te svaruar qendrueshmerine e tendencies (graf. 4.1).

Grafiku 4.1 Nivele te PM10 ne qytete te zones europiane te OBSH



Verehet gjithashtu edhe nje fenomen karakteristik lidhur me permbajtjen e grimcave te imta ne ajrin urban te Tiranes. Permbajtja e grimcave, PM 2.5 dhe PM 1 eshte praktikisht e njellojte ne qender te qytetit dhe ne periferi te tij. Kjo thekson gravitetin e problemit te grimcave te imta ne ajrin urban, dhe vendos studjuesit e vendimmarresit para detyrash jo te lehta per te luftuar ndotjen e ajrit ne te ardhmen.


Ne permbajtje te gazeve nuk ka ndonje ndryshim te rendesishem, nga qe dyoksidi i azotit NO<sub>2</sub> dhe benzeni kane thuajse te njejtet nivele me nje vit me pare. Por ajo qe ka rendesi eshte fakti se qe te dy keta gaze jane fare prane kufijve mesatare vjetore te lejuar prej KE, duke u bere faktor shtese ne mozaikun e ndotjes se ajrit te Tiranes.

Edhe pse ka nje permiresim te permbajtjes se grimcave ne ajer krahasuar me vitin 2011, Tirana vazhdon te mbeten nje qytet me ajer te rrezikshem per jeten ne qendren e saj. *Indeksi shendetos i cilesise se ajrit* (AQHI – formula 4.4), mjaft i njohur tani ne Ameriken Veriore (Kanada), ka gjithashtu nje permiresim te mases rreth 10 perqind, por qendron perseri prane atij qe konsiderohet kufi i ajrit te rrezikshem per jetesen e popullates (tab.4.2 dhe grafiku 4.3).

Tab. 4.2

	AQHI Qender	AQHI ISHP
Janar	<b>7.4</b>	<b>7.04</b>
Shkurt	6.9	5.85
Mars	<b>7.8</b>	5.4
Prill	6.74	4.31
Maj	6.24	4.5
Qershor	6.59	4.65
Korrik	6.69	4.91
Gusht	<b>7.89</b>	5.92
Shtat.	6.98	4.96
Tetor	6.35	4.1
Nentor	6.85	3.96
Dhjetor	<b>8.46</b>	5.07
Mesatare	7.07	5.06

Grafiku 4.3



#### Formula 4.4

$$\text{AQHI} = 10/10.4 * (100 * (e^{(0.000871 * \text{NO}_2)} - 1 + e^{(0.000537 * \text{O}_3)} - 1 + e^{(0.000487 * \text{PM}_{2.5})} - 1))$$

In this equation, NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub> and PM<sub>2.5</sub> (nitrogen dioxide, ozone and fine particulate matter less than 2.5 microns in size, respectively) are concentrations averaged over three consecutive hours. Units are parts per billion for each gas and micrograms per cubic metre for PM<sub>2.5</sub>.

Me poshte jepet shkalla e AQHI (Indeksi Shendetos i Cilesise se Ajrit) nga 1 to 10+.


Kategorite koresponduese te rrezikut per shendetin human listohen si:



Sic shihet ky indeks shendetos i cilesise se ajrit ka ne bazen e llogaritjes se vet veprimin e kombinuar te ozonit O<sub>3</sub>, dyoksidit te azotit NO<sub>2</sub> dhe grimcave shume te imta PM 2.5 mbi organizmin e njeriut, prandaj ndonese permbytja e grimcave te imta (PM 10/PM2.5) ne qendren e qytetit ka shenuar nje ulje te konsiderueshme gjate vitit 2012 ne krahasim me vitin 2011 kryesisht per efekt te normalizimit te trafikut, nuk jane ulur aspak gazet ozon O<sub>3</sub> e dyoksid i azotit NO<sub>2</sub>. Kjo situate ilustrohet mire prej tab. e grafikut 4.5 me poshte:

Tab.4.5

	AQHI>7	PM10>50
Viti 2011, dite	201	156
Viti 2012, dite	170	49
Norma KE		35



Situata te tilla tashme jane analoge edhe ne qytete te tjere europiane. Duhet patur parasysh gjithashtu qe aktualisht ne vendet perendimore niveli shkencor i interpretimit te rezultateve te indekseve te monitoruar per cilesine e ajrit, po ecen paralel me perparimin e madh te studimeve te epidemiologjise humane, qe lidhin semundshmerine dhe vdekshmerine e popullatave urbane me sete fleksibel te parametrave te ajrit mjedisor.

Ne kete kontekst, na duket me vend te citojme vleresimin qe i behet cilesise se ajrit ne Londer, ne mars te vitit 2010, nga ana e nje komisioni auditues zyrtar te parlamentit anglez:

*Cilesia e keqe e ajrit shkakton me shume vdekje dhe semundshmeri se sa duhan pirja pasive, aksidentet rrugore dhe obeziteti. Megjithate ajo ka pak apo aspak vemendje ne media dhe vemendje te neglighueshme ne Parlament dhe brenda Qeverise..*

## Apendiks A

Njerezit mund te preken ne menyre te demshme prej ajrit te ndotur mjedisor. Prandaj KE dhe OBSH ka perpunuar nje legjislacion te gjere qe permban standarde te karakterit shendetosor dhe objektiva per nje numer ndotesish te ajrit. Keta standarde dhe objektiva jane permblehdhur ne tabelen A1 dhe A2 me poshte. Keta perdoren per periudha te ndryshme kohe nga qe ndikimet shendetosor te verejtur cfaqen pas periudhash te ndryshme ekspozimi kohor.

Tabela A1

<i>Ndotesi</i>	<i>Perqendrimi</i>	<i>Periudha kohore</i>	<i>Natyra ligjore</i>	<i>Tejkalimet e lejuara cdo vit</i>
Grimcat e imta (PM2.5)	25 µg/m <sup>3</sup> ***	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2010	n/a
Dyoksid i squfurit (SO <sub>2</sub> )	350 µg/m <sup>3</sup>	1 ore	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2005	24
	125 µg/m <sup>3</sup>	24 hours	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2005	3
Dyoksid i azotit (NO <sub>2</sub> )	200 µg/m <sup>3</sup>	1 ore	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2010	18
	40 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2010*	n/a
PM10	50 µg/m <sup>3</sup>	24 ore	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2005**	35
	40 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2005**	n/a
Plumbi (Pb)	0.5 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2005 (ose 1.1.2010 ne afersi direkte me burime industrial te specifikuar; dhe nje vlore kufi 1.0 µg/m <sup>3</sup> u perdon nga dt 1.1.2005 deri 31.12.2009)	n/a
Moniksidi i karbonit (CO)	10 mg/m <sup>3</sup>	Mesatarja maksimale ditore 8 oreshe	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2005	n/a
Benzeni	5 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2010**	n/a
Ozoni	120 µg/m <sup>3</sup>	Mesatarja maksimale ditore 8 oreshe	Vlera hyri ne fuqi me dt 1.1.2010	25 dite mesatare per 3 vjet
Arseniku (As)	6 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt 31.12.2012	n/a
Kadmiumi (Cd)	5 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt	n/a

			31.12.2012	
Nikeli (Ni)	20 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt 31.12.2012	n/a
Hidrokarburet aromatike policiklike	1 ng/m <sup>3</sup> (shprehur si perqendrim il Benzo(a)pyrene)	1 vit	Vlera hyri ne fuqi me dt 31.12.2012	n/a

\* Sipas Direktives se re shteti anetar mund te aplikoje per nje zgjatje afati deri pese vjet....

\*\*Sipas Direktives se re shteti anetar ka qene ne gjendje te aplikonte per nje zgjatje afati deri tre vjet pas dates se hyrjes ne fuqi te Direktives se re (dmth Maj 2011) ne nje zone specifike...

\*\*\*Standardi i futur prej Direktives se re..

Tabela A2

Vlerat e reja te OBSH per Udhezimet per Ndotesit e Ajrit, (2008)

<i>Ndotesi</i>	<i>Periudha kohore</i>	<i>Vlera e Udhezimit te Ndotjes se Ajrit (AQG) (<math>\mu\text{g}/\text{m}^3</math>)</i>
Lenda e grimcuar		
PM2.5	1 vit	10
	24 ore	25
PM10	1vit	20
	24 ore	50
Ozon, O <sub>3</sub>	8 ore, maksimale ditore	100
Dyoksid azoti, NO <sub>2</sub>	1 vit	40
	1 ore	200
Dyoksid squfuri, SO <sub>2</sub>	1 vit	20
	1 ore	500

## **Apendiks B**

### **Efektet shendetvore te ndotjes se ajrit**

Me poshte pershkruhen efektet shendetvore te ndotjes se ajrit.

#### **Monoksidi i karbonit**

Monoksidi i karbonit eshte nje gaz pa ere dhe ngjyre. Ai prodhohet nga djegia jo e plete e lendeve djegese. Ai kapet me lehte se oksigjeni prej rruazave te kuqe te gjakut dhe interferon keshtu me furnizimin e organizmit te njeriut me oksigjen. Ai eshte helmues ne perqendrime te larte, qe nuk hasen normalisht ne ajrin e jashtem.

Ne perqendrime te ulet ai mund te jape nje pakesim te vogel te performances maksimale fizike te individive te shendetshem dhe eshte oservuar qe shpejton fillimin e angines te individet me semundje koronare arteriale (OBSH, 2000).

#### **Dyoksoidi i azotit**

Dyoksoidi i azotit eshte nje gaz irritues, qe ka ngjyre te kuquerremte dhe shije te hidhur ne perqendrime shume te larte. Ne nivele te larte  $\text{NO}_2$  shkakton inflamacion te rrugeve te frymemarrjes. Te njerezit me shenja azmatike eksposzimi ndaj tij sjell efekte reversibel ne funksionin e mushkerive, dhe mendohet se shkakton reagim te ekzagjeruar ndaj alergenteve, ajrit te ftohte dhe aktivitetit fizik. Eksposzimi ndaj tij i vendos femijte nen rrezik te rritur per semundje te frymemarrjes (OBSH, 2000). Dyoksoidi i azotit perdoret si shenues per nje 'koktejl ndotesish qe lidhen me djegien' (OBSH, 2005). Ndersa efektet shendetvore te permendor me lart Jane te lidhur specifikisht me dyoksidin e azotit, nivelet e larte te  $\text{NO}_2$  mund te tregojne nivele te larte te ndotesve te tjere qe kontribujne ne efekte shtese te demshem mbi shendetin.

#### **Dyoksoidi i squfurit**

Dyoksoidi i squfurit eshte nje gaz pa ngjyre me nje ere disi te embel e mbytese.  $\text{SO}_2$  prodhohet prej djegies se lendeve djegese industriale e shtepiake. Eksposzimi afat shkurter ndaj perqendrimeve te larte te  $\text{SO}_2$  rezulton ne reduktim te funksionit te mushkerive. Eksposzimi afat gjate mendohet se con ne semundje respiratore te femijve dhe vdekshmeri te rritur te te gjitha moshave (OBSH, 2005). Femijte e vegjel dhe njerezit qe vuajne prej azmes dhe semundjeve kronike te frymemarrjes jane vecanerisht te ndjeshem ndaj  $\text{SO}_2$ .

#### **Ozoni**

Ozoni eshte nje gaz me ngjyre blu te zbehte me shije cpuese. Ai eshte nje ndotes sekondar qe krijohet si resultat i reaksioneve kimike ndermjet ndotesish te ndryshem te tjere te ajrit; kryesisht te  $\text{NO}_x$  dhe komponimeve organik flurore (VOC), te inicuar prej drites se forte te diellit. Efektet e eksposimit afat shkurter perfshijne simptoma respiratore, si kolle (OBSH, 2000) dhe irritim te syve dhe hundes.

Ekspozimet me te gjata reduktojne funksionin e mushkerive dhe rrisin incidenten e simptomave respiratore, te pranimeve spitalore per efekte respiratore dhe te vdekshmerise.

### **Grimcat**

Ndotja nga grimcat perbehet prej nje varieteti komponimesh dhe definohet prej diametrit aerodinamik , nje indikator i vendit ku do depozitohen grimcat ne trakin respirator. Grimcat identifikohen ose si PM10 (grimca me diameter aerodinamik me te vogel se  $10 \mu\text{m}$ ) ose si PM2.5 (grimca me diameter aerodinamik me te vogel se  $2.5 \mu\text{m}$ ) (WHO – Factsheet, Air Quality and Health, 2008). Ekspozimet si afat- shkurtera edhe afat- gjata jane treguar se shkaktojne semundje te frymemarrjes dhe te zemres, efekte te tjere te demshem shendetore dhe vdekje (OBSH, 2007). Ekspozimet afat gjata kontribuojne ne rrezikun e kancerit te mushkerive (OBSH, 2008). Sipas OBSH, per grimcat ‘nuk eshte e mundur te dallohet nje perqendrim kufi nen te cilin nuk ka efekte mbi shendetin e tere populates.’

### **Hidrokarburet aromatike: BTX**

Hidrokarburet aromatike jane kancerogjene te njohur, qe kane nje numer burimesh. Benzeni eshte ai qe ka me shume rendesi e qe monitorohet dy vitet e fundit ne qytetin e Tiranes . OBSH veren se ‘ne ajrin mjesidor nuk mund te specifikohet nivel absolutisht i parrezikshem per benzenin (OBSH, 2007). Burimet kryesore te tij jane djegjet shtepiake e industriale, si edhe transporti rrugor.

Edhe tolueni eshte monitoruar ne Tirane. Ekspozimet afat-shkurter e afat-gjate ndaj toluenit prekin sistemin nervor qendror, dhe tolueni mendohet se shkakton difekte ne lindje dhe ne zhvillim (OBSH, 2000).

Hidrokarburet aromatike digjen lehte duke prodhuar monoksid karboni dhe dyoksid karboni. Frymemarrja e hidrokarbureve aromatike ne perqendrime te larte per periudha te gjata kohe shkakton lodhje, dhembje koke, marrje mendsh dhe te vjella.

## Apendiks C

Permbledhje e niveleve mesatare vjetore te ndotesve ne vitin 2012

<b>Ndotesi</b>	<b>Mesatare vjetore (<math>\mu\text{g}/\text{m}^3</math>)</b>	<b>Vendi i monitorimit</b>	<b>Mbi apo nen norme KE</b>	<b>Koment</b>
CO	0.55 ( $\text{mg}/\text{m}^3$ )	Poliklinika qendrore	Nen	Matur ne $\text{mg}/\text{m}^3$
	0.36 ( $\text{mg}/\text{m}^3$ )	ISHP	Nen	Matur ne $\text{mg}/\text{m}^3$
$\text{NO}_2$	42.6	Poliklinika qendrore	<b>Mbi</b>	
	6.5	ISHP	Nen	
	3.5	Linze	Nen	
	11.5	Kombinat	Nen	
	17.2	Kodra Diellit	Nen	
	65.1	21 Dhjetori	<b>Mbi</b>	
	29.6	Stad. S.Stermasi	Nen	
	33.7	DSHP	Nen	
	52.4	Stac. trenit	<b>Mbi</b>	
	66.4	Zogu i Zi	<b>Mbi</b>	
	30.2	Klinika iraniane	Nen	
	49.2	Farmacia 10	<b>Mbi</b>	
$\text{SO}_2$	8.4	Poliklinika qendrore	Nen	
	5.1	ISHP	Nen	
	4.6	Linze	Nen	
	13.1	21 Dhjetori	Nen	

	6.2	DSHP	Nen	
	16.9	Zogu i Zi	Nen	
Ozon	65.8	Poliklinika qendrore	Nen	Brenda mesatares vjetore te KE, por 24 dite mbi normen ditore 8 oreshe, nga 18 te lejuara
	92.9	ISHP	Nen	Brenda mesatares vjetore te KE, por 99 dite mbi normen ditore 8 oreshe, nga 18 te lejuara
Grimca te imta (PM10)	34.2	Poliklinika qendrore	Nen	Brenda mesatares vjetore te KE, por 49 dite mbi normen ditore 50 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ , nga 35 te lejuara
	38.1	ISHP	Nen	Brenda mesatares vjetore te KE, por 80 dite mbi normen ditore 50 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ , nga 35 te lejuara
Grimca shume te imta (PM2.5)	20.1	Poliklinika qendrore	Nen	
	19.8	ISHP	Nen	
Benzen	4.05	Poliklinika qendrore	Nen	

2.79	ISHP	Nen	
2.04	Linze	Nen	
1.85	Kombinat	Nen	
2.51	Kodra Diellit	Nen	
5.1	21 Dhjetori	Mbi	
2.88	Stad. S.Stermasi	Nen	
3.44	DSHP	Nen	
3.15	Stac. trenit	Nen	
3.37	Zogu i Zi	Nen	
3.76	Klinika iraniane	Nen	
1.74	Farmacia 10	Nen	